

Përfshirja Financiare - Forumi i Politikave në Evropë dhe Azinë Qendrore

Deklarata e koncensusit të përbashkët

Shkup, 26 Tetor, 2015

Ne, politikë bërësit dhe rregullatorët nga rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore (EAQ), u takuam në Shkup, Maqedoni më 26 tetor 2015 me ftesë të Aleancës për Përfshirjen Financiare (APF) dhe Bankës Kombëtare të Republikës së Maqedonisë (BKRM), me mbështetjen e Ministrisë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim të Gjermanisë (BMZ) dhe Sekretariatit të Shtetit për Çështje Ekonomike të Zvicrës (SECO). Diskutuam mënyrat e forcimit të të mësuarit kolegjial dhe shkëmbimin e njohurive me qëllim që të avancojmë përfshirjen financiare në vendet tona dhe në të gjithë rajonin e EAQ.

Ne ekzaminuam, së bashku me APF dhe partnerët e saj, mundësitë dhe sfidat për të zgjeruar përfshirjen financiare në EAQ. Ne shkëmbyem mendime mbi potencialin për qasjet e reja ndaj politikave, rregullimin dhe përkrahjen që do të mund të kontribuojë në mënyrë efektive për të përmirësuar qasjen në shërbime financiare cilësore për popullsinë e përjashtuar financiarisht në EAQ, dhe reflektimin mbi rolin e politikë bërësve dhe rregullatorëve në krijimin e një ambienti të përshtatshëm për zgjerimin e shërbimeve cilësore financiare në vendet tona dhe në mbarë rajonin.

Pas diskutimeve tona, ne kemi rënë dakord për sa më poshtë:

- Ne pranojmë se përfshirja financiar është një politikë prioritare për institucionet tona.
- Ne angazhohemi karshi njëri-tjetrit se do të adresojmë këtë prioritet duke ndarë me njëri – tjetrin dijet dhe njohuritë që të çojnë në zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe rregulloreve të reja.
- Ne konfirmojmë se ka një nivel të lartë të interesit dhe përkushtimit midis institucioneve tona për të përshkallëzuar mësimin kolegjial në politikën e përfshirjes financiare brenda rajonit EAQ.
- Ne ramë dakord që zonat e përbashkëta të prioritetit brenda fushës së politikës së përfshirjes financiare në rajonin e EAQ do të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: (1) Literaturën Financiare dhe atë për Mbrojtjen e të Drejtave të Konsumatorit; (2) NVM Financiare, (3) Shërbimet Financiare Digitale; (4) Të Dhënat mbi Përfshirjen Financiare.

Ne ramë dakord të lejojmë mundësinë për të përfshirë fusha të tjera të politikave prioritare në të ardhmen.

- Ne gjithashtu pranojmë një nivel të lartë të interesit në forcimin e mësimit kolegjial ndërmjet

institucioneve politikë bërëse në EAQ me politikë bërësit në kuadër të rrjetit APF në pjesë të tjera të botës.

- Ne pajtohemi se dialogu publiko-privat sistematik është një element i rëndësishëm për tu informuar mbi projektimin dhe zbatimin e politikave. Përveç kësaj, ne e mirëpresim mbështetjen e sektorit privat në forcimin e kapaciteteve teknike të institucioneve tona në zonat ku sektori privat ka ekspertizë të konsiderueshme.
- Ne ramë dakord që APF është pozicionuar në mënyrë unike për të çuar përpara iniciativën rajonale të të mësuarit kolegjial në EAQ. I bëjmë thirrje APF-së të lancojë platformën rajonale të të mësuarit kolegjial dhe zotohemi se institucionet tona do të kenë pjesëmarrje aktive në këtë platformë.
- Ndaj ne inkurajojmë partnerët e APS-së, financuesit dhe palët e interesuara, duke përfshirë SECO dhe BMZ, të mbështesin ecurinë dhe zbatimin e kësaj iniciative.